



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Datë: 12.04.2021

Për: **“2 N” SHPK**

Lagja "Paskuqan Fushë", Rruga "Demokracia", Pallati Nr. 2, Kati i Parë, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për propozim”** –Shërbime – Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër, me objekt: **“Mirëmbajtje objekti ndërtimor për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci”**, me fond limit: **6,989,933** (gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH dhe me nr. **REF-86459-02-09-2021**.

Numri i referencës: **REF-86459-02-09-2021**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mirëmbajtje objekti ndërtimor për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci”**, me fond të marrëveshjes kuadër: **6,989,933** (gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë, (pa TVSH).

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: 24 (njëzetë e katër) muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike data 15 Shkurt 2021, Nr. 21.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Për këtë procedurë prokurimi, njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1) **“2 N” SHPK**

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: **3,913,889** (tre milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë (pa TVSH)

(me numra dhe fjalë)

L31615017L

numri i NIPT-it

2) **“DELIA IMPEX” SHPK**

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: **4,165,140** (katër milion e njëqind gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzetë) lekë (pa TVSH)

(me numra dhe fjalë)

K57123001R

numri i NIPT-it

- 3) “HYSI-2 F” SHPK **K72429007E**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
 Vlera: **5,025,325** (pesë milion e njëzet e pesë mijë e treqind e njëzetë e pesë) lekë (pa TVSH)
 (me numra dhe fjalë)
- 4) “NIKA” SHPK **J76705047U**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
 Vlera: **5,306,425** (pesë milion e treqind e gjashtë mijë e katërqind e njëzetë e pesë) lekë (pa TVSH)
 (me numra dhe fjalë)
- 5) “VALONA KONSTRUKSION” SHPK **K26330202E**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
 Vlera: **5,308,460** (pesë milion e treqind e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë (pa TVSH)
 (me numra dhe fjalë)

Për këtë procedurë prokurimi, janë s’kualifikuar Operatorët Ekonomikë si vijon:

- 1) “DELIA IMPEX” SHPK **K57123001R**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
- 2) “NIKA” SHPK **J76705047U**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
- 3) “VALONA KONSTRUKSION” SHPK **K26330202E**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

1- Arsyet e skualifikimit për “DELIA IMPEX” SHPK;

- Ofertuesi nuk plotëson gjermën b (*Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1*), pika 2, “ Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi nuk ka përcaktuar asnjë nga alternativat a dhe b, të pikës 6 të kësaj deklaratë.

2- Arsyet e skualifikimit për “NIKA” SHPK;

- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gjermën dh), pika 1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk arriti të provojë se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik. Referuar Vërtetimit të Debitit datë 28.01.2021 të paraqitur në SPE nga ofertuesi, rezultoi se ky i fundit nuk ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike për muajin Janar 2021.

- Ofertuesi nuk plotëson pikën 7, gjërma f), seksioni 2.3 “Për kapacitetin teknik” tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesë Certifikatë për transport mallrash në emër të tij për mjetin “Autovinc me kosh”. Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar, vërtetohet se çertifikata e mjetit me targë AB954AM të cilin e disponon personi fizik “Orest Potka” sipas lejes së qarkullimit, është specifike dhe e lëshuar për kryerjen e transportit të mallrave, brenda vendit, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e operatorit ekonomik “NIKA” SHPK me kamionin e personit fizik “Orest Potka” do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave

me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

3- Arsyet e skualifikimit për “VALONA KONSTRUKSION” SHPK;

- Ofertuesi nuk plotëson gjurmën a (Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1), pika 2 “ Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi oferta ekonomike e paraqitur në SPE rezulton me gabim aritmetikor më të lartë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Bazuar në Vendimin nr. 914 datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 66 Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. “Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”. Pas korrigjimeve të gabimtaritmetik, oferta rezulton në shumën 5,647,760 lekë pa TVSH.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

Operatori Ekonomikë “**2 N**” SHPK, me nr. NIPT **L31615017L** me ofertë ekonomike **3,913,889** (tre milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë (pa TVSH), me adresë: Lagjja "Paskuqan Fushë", Rruga "Demokracia", Pallati Nr. 2, Kati i Parë. Tiranë.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë, Tel: +355 42247865, menjëherë nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.03.2021

Ankesa: Po

Marrë përgjigje me Vendimin e KSHA-së nr. 631/2 datë 26.03.2021, njoftuar me shkresën nr. 631/3 datë 29.03.2021

TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM